



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Raporti Vjetor 2018

Rrjeti i Grave të Kosovës

Raporti Vjetor 2018



© Rrjeti i Grave të Kosovës, prill 2019

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, duke cituar burimin.

Ky raport është përgaditur nga anëtarët e stafit të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), të përkrahura nga Agjencioni Austriak për Zhvillim, Fondacioni Kvinna till Kvinna, dhe Bashkimi Evropian, si përgjegjësi e RrGK-së për të raportuar tek organizatat anëtare të saj. Përmbajtja e këtij raporti është vetëm përgjegjësi e RrGK-së dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të donatorëve të lartëpërmendur.

www.womensnetwork.org



Përmbajtja

LETËR NGA KRYETARJA E BORDIT TË RrGK-së	8
HYRJE	11
Vizioni ynë	11
Misioni ynë	11
Strategjia jonë.....	11
Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së.....	13
NGRITJA E KAPACITETEVE TË RrGK	14
Është rritur solidariteti mes organizatave të grave në Kosovë	14
Është përmirësuar kapaciteti organizativ i RrGK dhe anëtareve të saj drejt avokimit dhe qëndrueshmërisë afatgjate të rrjetit	17
Është përmirësuar klima e financimit për organizatat për të drejtat e grave	23
GRATË NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE.....	25
Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel komunal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore.....	25
PËRMIRËSIMI I QASJES SË GRAVE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR CILËSOR	32



Zyrtarët publik dhe institucionet shëndetësore të jenë më përgjegjëse në adresimin e shkeljes së të drejtave të grave për kujdes shëndetësor.....	32
Më shumë gra kanë qasje në kujdes shëndetësor cilësor	34

JETA PA DHUNË ME BAZË GJINORE..... 37

Përmirësohet zbatimi i kornizës ligjore të dhunës në familje, duke përfshirë përgjigjet institucionale në ndihmën ndaj personave që kanë pësuar dhunë	37
Është përmirësuar ndërgjegjësimi dhe vëmendja në radhët e zyrtarëve dhe qytetarëve lidhur me trajtimin e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual	42
Hartohen politikat dhe përmirësohen procedurat për trajtimin e ngacmimit seksual	44
Përmirësohet mbështetja institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës.....	45

MBËSHTETJA PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE..... 47

Më shumë gra sigurojnë punësim	47
Më shumë gra kanë qasje në trashëgimi dhe pronësi.....	50
Përmirësohet shkalla në të cilën politikat dhe programet e BE-së përfshijnë perspektivën gjinore dhe është përmirësuar mbikëqyrja nga një perspektivë gjinore në lidhje me politikat dhe programet e BE-së në Kosovë.....	50

VLERËSIMI I PUNËS SË RrGK 53



RAPORTI FINANCIAR I RrGK PËR 2018	55
RRETH NESH	62
Bordi Drejtues i RrGK	62
Hulumtuesit dhe anketuesit e RrGK	64
Përkrahësit/et individual/e të RrGK Personat në vijim (në renditje alfabetike) kontribuan në përkrahjen e RrGK-së dhe punës së saj. Jemi shumë mirënjohës për përkrahjen e tyre!	65
Organizatat Anëtare të RrGK	67
Shtojca 1. Grantet e Fondit të Grave të Kosovës në vitin 2018	81
Shtojca 2. Të arriturat e avokimit nga Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë në vitin 2018	88



LETËR NGA KRYETARJA E BORDIT TË RrGK-së

Të nderuar/a bashkëaktivist/e,

Me këtë letër dëshiroj të ju përgëzoj për një vit të suksesshëm, përgjatë të cilit bashkarisht kemi tejkaluar plot sfida, pengesa dhe vështirësi. Shfrytëzoj rastin të ju përgëzoj për punën e palodhshme dhe energjinë që keni treguar gjatë vitit që po lëmë pas. Nuk ka qenë e lehtë, por asnjëra/asnjëri nuk jemi dorëzuar pranë sfidave dhe pengesave të shumta strukturore dhe sistematike të cilat kemi hasur.

Ishte një vit i vështirë dhe emocionues, i cili ka mbetur të karakterizohet në mes tjerash me vazhdimin e papunësisë së lartë të grave dhe vajzave, rritjen e rasteve të raportimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave por edhe rasteve me pasoja tragjike për gratë dhe fëmijët viktime të dhunës në familje si dhe përfaqësimin jo-adekuat të grave në vendimmarrje. Në përgjithësi, ishte një vit që shumë lehtë me situata të ndryshme na vendosi në situata të dëshpëruara por edhe na rikthej në krye të detyrave tona, secila në rolin tonë individual por edhe të mobilizuar së bashku të reagojmë në forma të ndryshme ndaj këtyre padrejtësive. Qëndruam bashkë dhe nuk hezituan të përdorim analiza, fakte por edhe forma tjera aktive sikurse protestat, marshet dhe debatet e ndryshme për të i diskutuar këto padrejtësi në publik. Do të doja të theksoj edhe rolin e veçantë dhe bashkëpunimin e senzibilizimin e mediave që në mënyrë aktive raportuan këto padrejtësi apo shkelje që u identifikuan këtë vit.



Të jesh pjesë e Rrjetit të Grave të Kosovës në fakt është një mision dhe besoj se ne me punën dhe vullnetin tonë e tregojmë çdo ditë se jemi pjesë e një rrjeti ku do të vazhdojmë të mobilizohemi individualisht por edhe kolektivisht në realizimin e misionit të krijimit të një shoqërie të barabartë ku të gjithë kanë mundësinë të japin kontributin real në zhvillimin e vendit të tyre. Kjo e bën edhe angazhimin tonë një mision të pazëvendësueshëm për t'i ofruar mundësi vajzave dhe grave të shumta. Një shoqëri me mundësi zhvillimi dhe mundësi që secili person ta realizojë potencialin e vet të plotë, jo të penguar nga dhuna, diskriminimi në punësim apo në vendimmarrje mbetet, një mision i përbashkët.

Në baza ditore stafi i Rrjetit, 141 organizatat anëtare si dhe anëtarët e Bordit, kanë mundur të vazhdohet puna me vullnet, energji dhe ambicie për të kërkuar eliminimin e tipareve seksiste dhe krijimin e një shoqërie të barabartë. Rrjeti i Grave është ndihmuar dhe ka vazhduar bashkëpunimin me partnerë të ndryshëm institucional, sektorin e shoqërisë civile si dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare, me qëllim të njohjes së rolit aktiv të grave dhe vajzave të Kosovës në proceset e ndryshme të shtet-ndërtimit përfshirë këtu edhe përfaqësimin në iniciativat e ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare.

Ndër të tjera, këtë vit kemi përfunduar zbatimin e Strategjisë së RrGK-së 2015-2018 me sukses të madh. Merita për këtë sukses qëndron tek ju, secila anëtare e Rrjetit. Tani është koha të shikojmë përpara, drejt zbatimit të Strategjisë së re 2019-2022. Kjo Strategji e re dhe ambicioze përshkruan vizionet strategjike, aktivitetet konkrete dhe treguesit për të ndihmuar anëtarët e Rrjetit në përmbushjen e qëllimeve drejt



mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët në Kosovë. Procesi i hartimit të kësaj strategjie na ka mundësuar të reflektojmë mbi sukseset dhe vështirësitë që kemi hasur në të kaluarën. Njëkohësisht, na ka mundësuar të përcaktojmë vizionet dhe qëllimet e ardhshme krahas ndryshimeve dhe nevojave të reja që janë shfaqur. Procesi konsultativ drejt finalizimit të kësaj strategjie ka vënë në pah nevojën e RrGK-së për tu fokusuar në gjashtë fusha. Fushat që parashihen në këtë strategji përfshijnë: I) Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë; II) Gratë në politikë dhe vendimmarrje; III) Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor; IV) Jeta pa dhunë me bazë gjinore ; V) Fuqizimi ekonomik i grave; dhe VI) Edukimi cilësor i barabartë. Tani vetëm duhet të vazhdojmë këtë punë së bashku deri në realizimin e aktiviteteve të parapara në Strategjinë e re katër vjeçare të RrGK-së.

Edhe njëherë, ju përgëzoj përzemërsisht për punën e palodhshme gjatë vitit 2018. Njëkohësisht shfrytëzoj rastin t'ju uroj punë të mbarë, energji dhe suksese të shumta në vitin 2019.

Përzemërsisht,

Ariana Qosaj - Mustafa



HYRJE

Vizioni ynë

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) **parasheh** që në shtetin e Kosovës gratë dhe burrat të jenë të barabartë dhe të kenë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje në politikë, kujdes shëndetësor dhe një jetë pa dhunë.

Misioni ynë

Misioni i Rrjetit është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, feja, mosha, niveli i arsimit, orientimi seksual dhe aftësitë. RrGK përmbush misionin e saj përmes shkëmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, hulumtimeve, avokimit dhe të shërbimeve.

Strategjia jonë

Për të përmbushur vizionin dhe misionin e saj, RrGK ka [Strategjinë për periudhën 2015-2018](#), të cilën mund ta gjeni në faqen tonë të internetit. Qëllimi i kësaj strategjie ishte që të drejtojë punën e RrGK-së gjatë kësaj periudhe. Strategjia është përpiluar në vitin 2014 me të dhëna nga organizatat anëtare të rrjetit, bordi drejtues, partnerët dhe palët tjera relevante. Strategjia e RrGK-së ka pesë fusha programatike: I) Ngritja e kapaciteteve të RrGK; II) Gratë në politikë dhe vendimarrje; III) Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor; IV) Programi



kundër dhunës me baza gjinore; dhe V) Fuqizimi ekonomik i grave. Ky raport tregon përparimin e bërë në secilën nga këto fusha gjatë vitit 2018.

Në fillim të vitit 2018, RrGK ka nisur planifikimin dhe përpilimin e Strategjisë së re të RrGK për vitet 2019-2022 përmes një takimi dyditor me anëtarët e saj në muajin prill. Pas mbledhjes së të dhënave dhe me kontributin e anëtareve për të plotësuar Strategjinë, RrGK ka mbajtur takimin e dytë në nëntor, ku së bashku me anëtarët dhe bashkëpunëtorët kyç ka finalizuar Strategjinë. Ajo u miratua në mbledhjen vjetore të Kuvendit të Anëtareve me 15 dhjetor në Prishtinë. Anëtarët e RrGK-së vendosën që Strategjia e RrGK për vitet 2019-2022 do të përfshijë fushat programatike në vijim: I) Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë; II) Gratë në politikë dhe vendimmarrje; III) Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor; IV) Jeta pa dhunë me bazë gjinore; V) Fuqizimi ekonomik i grave; dhe VI) Edukim cilësor i barabartë.



Anëtarët e RrGK planifikojnë dhe përpilojnë Strategjinë e re të RrGK për vitet 2019-2022 në Durrës.

Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së

Çdo vit, Rrjeti raporton te anëtarët e veta, te partnerët dhe miqtë lidhur me përparimin që është bërë drejt arritjes së objektivave strategjike. Ky raport përmban informata lidhur me aktivitetet e RrGK nga 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018. Ky raport është i ndarë në pesë pjesë bazuar në objektivat afatgjata dhe programet e Rrjetit:

- Ngritja e kapacitetit të RrGK-së;
- Përkrahja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i qasjes së grave në kujdes shëndetësor cilësor;
- Zvogëlimi i dhunës në baza gjinore;
- Avancimi i fuqizimit ekonomik të grave.

Ky raport prezanton të arriturat dhe rezultatet për vitin 2018, lidhur me secilin nga këto programe. Përgjatë këtij raporti, prezantohet edhe progresi i arritur për tërë strategjinë nga viti 2015 deri në vitin 2018. Pjesët e mëposhtme përmbajnë informata lidhur me progresin e arritur drejt çdo objektiwi dhe rezultati të pritur vetëm për vitin 2018. Raporti gjithashtu përmban informata rreth buxhetit, mbështetësve, Bordit të Drejtorëve, Bordit Këshillëdhënës, stafit, praktikantëve, vullnetarëve, anëtareve dhe përfituesve të granteve.

NGRITJA E KAPACITETEVE TË RrGK

Qëllimi kryesor i programit për ngritjen e kapaciteteve të RrGK është që të egzistojë një lëvizje e qëndrueshme e grave në Kosovë. Një indikator që tregon se RrGK ka bërë progres në arritjen e këtij qëllimi është se RrGK ka zbatuar së paku 88 % të Strategjisë së saj për vitet 2015-2018. Më tutje, numri i përkrahësve individual të RrGK-së është rritur nga 59 në 79; përderisa vajzat e djemtë kanë ndërmarrë 10 iniciativa për mbështetjen e lëvizjes, duke treguar që gjeneratat e ardhshme kanë kapacitete që të vazhdojnë këtë lëvizje. Anëtarët e RrGK dhe të Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë kanë vazhduar të jenë shumë aktive dhe të zëshme.

Në vitin 2018, RrGK kishte rezultatet e mëposhtme, të cilat kontribuan në arritjen e qëllimit të këtij programi.

Është rritur solidariteti mes organizatave të grave në Kosovë

Përvoja e RrGK-së tregon që përkrahja dhe ruajtja e solidaritetit në mes të organizatave të grave janë vendimtare për ndërtimin e një lëvizjeje të qëndrueshme të grave. RrGK ka arritur këtë rezultat, siç shihet nga 32 partneritete, koalicione dhe iniciativa të përbashkëta në vitin 2018, ndërsa 90 që nga viti 2015, si dhe përmes arritjes së rezultateve të pritshme të shënuara më poshtë.



Anëtarët e RrGK-së janë informuar për nismat e anëtareve tjera, aktivitetet e RrGK, mundësitë e financimit dhe informacione të tjera

RrGK ka organizuar tri takime të rregullta tremujore të anëtarësisë, përmes të cilave 234 anëtare, partnerë dhe përkrahës të ndryshëm kanë shkëmbyer informata dhe u informuan për aktivitetet që po zhvilloheshin në vazhdimësi nga RrGK dhe nga organizatat tjera. Që nga viti 2015 gjithsej 1,053 gra dhe burra kanë marrë pjesë në takimet e rregullta të anëtarësisë. Gjatë takimeve, anëtarët e RrGK-së luajtën rol të rëndësishëm në bashkëpunimin drejt zbatimit të strategjisë së RrGK-së, si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e punës së RrGK-së.

Më shumë vajza dhe djem aktivistë të përfshirë në lëvizjen e grave

RrGK ka shpërndarë informata në faqen e Facebook-ut të FemACT duke u munduar të përfshijë vajza dhe djem në aktivitetet e ndryshme. Këtë vit, RrGK ka përfshirë gjithsej 269 vajza dhe djem përmes punës në RrGK apo përmes aktiviteteve. Që nga viti 2015 RrGK ka përfshirë gjithsej 2,867 të rinjë në aktivitetet e RrGK. Kjo u ka dhënë mundësi atyre të bëhen të shkathët në organizim, hulumtim, avokim, integrim të çështjeve



Anëtarët e RrGK gjatë mbledhjes tremujore të anëtarësisë, të mbajtur në qershor në Prishtinë.

gjinore në avokimin për të drejtat e njeriut, monitorim të çështjeve gjyqësore, si dhe të njoftohen me çështjet dhe problemet me të cilat përballen gratë në Kosovë drejt avancimit të barazisë gjinore.

Forcimi i mirëkuptimit ndëretnik dhe bashkëpunimi ndërmjet individëve dhe grupeve të shoqërisë civile

RrGK ka qenë e përfshirë në së paku 18 iniciativa ndëretnike vetëm në vitin 2018. Krahas ndërtimit të bashkëpunimit përmes takimeve të rregullta të RrGK-së dhe nismave të përbashkëta të avokimit, RrGK u ka ofruar mundësi për bashkëpunim ndëretnik organizatave që kanë marrë grante përmes Fondit të Grave të Kosovës dhe përfituesëve të tyre.

RrGK gjithashtu mori pjesë në disa koalicione dhe partneritete ndëretnike, duke përfshirë: një koalicion rajonal të financuar nga BE për të trajtuar diskriminimin me bazë gjinore në punë; një koalicion rajonal kundër femicidit; një iniciativë e përbashkët rajonale për avokim për draftimin e rekomandimeve për [Rezolutën Parlamentare Evropiane për Barazinë Gjinore në Ballkanin Perëndimor](#); një dokument i përbashkët rajonal dhe avokim lidhur me financimin e ofruesve të shërbimeve që mbështesin gratë që kanë vuajtur dhunën me bazë gjinore; një koalicion rajonal për të hulumtuar dhe ofruar rekomandime të politikave për përmirësimin e financimit për organizatat dhe lëvizjet e të drejtave të grave; një nismë globale për të krijuar strategji feministe; avokim i përbashkët me grupet tjera të të drejtave të grave në rajon drejt zbatimit të Planit të Veprimit Gjinor (PVGj) II të BE-së; dhe diskutime për të identifikuar objektivat dhe treguesit e përbashkët për zbatimin e PVGj II në Kosovë me gratë dhe burrat në Mitrovicën e Veriut.



Është përmirësuar kapaciteti organizativ i RrGK dhe anëtareve të saj drejt avokimit dhe qëndrueshmërisë afatgjate të rrjetit

Një lëvizje e qëndrueshme e grave nuk mund të ekzistojë pa anëtarët e saj që e mbajnë gjallë lëvizjen. Prandaj, RrGK vazhdimisht mbështetë anëtarët e saj në avancimin e kapaciteteve të tyre. Përmes mentorimit dhe Fondit të Grave të Kosovës, RrGK ka përkrahur anëtarët e saj në avancimin e kapaciteteve të tyre organizative.

Në vitin 2018, RrGK ka filluar me Vlerësimin e Kapaciteteve Organizative dhe Avokuese të organizatës (OACA). Kjo metodologji e respektuar, e zhvilluar nga USAID dhe e rafinuar nga East-West Management Institute, është përdorur në mbarë botën për vlerësimin dhe ngritjen e kapaciteteve organizative të OshC-ve dhe aftësive të tyre për të kryer avokim efektiv. Vlerësimi përdoret për të identifikuar pikat e forta si dhe nevojat e organizatave, që pastaj informon fushat në të cilat OShC-të mund të ngrisin kapacitetet e tyre. Gjatë vitit 2018, RrGK ka zhvilluar OACA-n me nëntë organizata anëtare të RrGK-së.

Puna e RrGK dhe e anëtareve të saj më e dukshme tek partnerët potencial, tek aktivistet e grave në nivel ndërkombëtar dhe tek mbështetësit e mundshëm

RrGK rregullisht ka promovuar punën e anëtareve të saj në faqen e internetit të [RrGK-së](#), faqen e [Facebook](#)- ut, dhe buletin elektronik mujor *Zëri i Grave Kosovare*. RrGK ka rritur numrin e ndjekësve në Facebook nga 16,498 që ishin në vitin 2017 në 18,018 në vitin 2018. Faqja në Facebook e RrGK-së lidhur me "FemACT"-in ka 787 ndjekës. RrGK gjithashtu menaxhon faqen e Lobit për Barazi Gjinore që tani ka 1,953 ndjekës. Gjithashtu, RrGK-ja vazhdon të përdorë medime të tjera sociale, siç është



Twitter-i, në të cilin numri i ndjekësve është rritur nga 647 në 780 dhe Instagram, ku numri i ndjekësve u rrit nga 1,101 në 1,279. Këtë vit RrGK-ja ka pasur 189,703 vizita në faqen e internetit; 56,613 sesione; dhe 35,972 përdorues. RrGK rregullisht shkruan artikuj për anëtarët e saj në buletinin mujor *Zëri i Grave Kosovare*, i cili lexohet nga 530 njerëz nëpër botë. RrGK gjatë vitit 2018 ka pasur 163 mbulime mediatike përfshirë artikuj dhe paraqitje në TV. RrGK ka dërguar 26 reagime/kumtesa për media këtë vit, duke përfshirë:

1. [Rrjeti i Grave të Kosovës mbështetë Presidenten Jahjaga](#) (6 shkurt)
2. [RrGK reagon pas lirimit të të akuzuarit kryesor për vrasjen e Donjeta Pajazitit](#) (6 mars)
3. [RrGK publikon raportin: *Nga Fjalët në Vepra?*](#) (9 dhe 12 mars)
4. Komunikatë e përbashkët: [GSBGJ reagon lidhur me ndryshimet e tanishme në plotësimin e Kodit Penal](#) (16 mars)
5. [RrGK kërkon urgjentisht zbardhjen e rastit të Antigona Morinës](#) (19 mars)
6. OShC-të reagojnë për deportimin e gjashtë qytetarëve turq 'gülenistë' nga Kosova (1 prill)
7. [RrGK dënon kanosjen e bërë nga zyrtari i KRU "Gjakova" Bujar Kokalla drejtuar deputetes Mimoza Kusari-Lila](#) (13 prill)
8. [Shoqëria e alarmuar nga rastet e dhunës ndaj grave](#) (16 prill)
9. [RrGK e shqetësuar me vendimin e Presidentit për njërin nga rastet e falura](#) (24 prill)
10. [Avokatja Bytyqi kërkon përjashtimin e gjyqtarit Shabani](#) (22 maj)



11. [Gratë në Politikë Ideojnë Strategji për Fuqizimin e Pjesëmarrjes së Grave në Politikë dhe Vendimmarrje në Kosovë](#) (13 qershor)
12. [RrGK kërkon përfshirjen e një definicioni specifik mbi Dhunën në Familje në ndryshim/plotësimin e Kodit Penal](#) (14 qershor)
13. [Bashkohen Gratë: Themelohet Koalicioni për Barazi](#) (22 qershor)
14. [#DrejtësipërAntigonën](#) (10 korrik)
15. [RrGK reagon për vrasjen në Gjakovë: Shteti Dështon në Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve](#) (8 gusht)
16. [RrGK reagon për vrasjen në Gjakovë: Edhe sa gra të vrara?](#) (20 gusht)
17. [#DrejtësipërDonjetën](#) (7 shtator)
18. [Roli i gruas vazhdon të nënvlerësohet nga politikanët](#) (12 shtator)
19. [Lansimi i Analizës Gjimore të Kosovës](#) (2 tetor)
20. [Fondi i Grave të Kosovës do të ndajë 47,992 € për 14 organizata të grave](#) (26 dhe 29 tetor)
21. [RrGK reagon për dënimin e ulët për Nrecajn](#) (2 nëntor)
22. [Koalicioni për Barazi diskuton: “Qeveria Feministe e Kosovës. Kur?”](#) (9 nëntor)
23. [Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës trajton gratë si objekte](#) (20 nëntor)
24. [Përfundon gjykimi për rastin e Antigones](#) (29 nëntor)
25. Letër drejtuar Deputetëve të Kuvendit të Kosovës (7 dhjetor)
26. [RrGK organizon Kuvendin Vjetor të 16-të të Anëtareve](#) (14 dhjetor)



RrGK është përpjekur që të përkthejë dhe vë në dispozicion të gjitha publikimet dhe shumë prej informatave në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht.

Anëtarët e RrGK aftësohen për të ngritur fonde, për të planifikuar në mënyrë më efektive, për të udhëhequr organizata dhe për të ndërmarrë iniciativa më efektive avokuese

Gjatë këtij viti, përmes Fondit të Grave të Kosovës (FGK), RrGK ka ndarë gjithsejt 12 grante, për 14 organizata anëtare të saj. Prej tyre, dy Grante në Partneritet për Ndryshim (deri në 8,000€) iu ndanë katër organizatave që do t'i zbatojnë në partneritet dhe 10 Grante Avokimi Individual (deri në 4,000€) iu ndanë organizatave individualisht. Këtë vit, FGK është përkrahur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me shumën prej 47,992€.

Grantet në Partneritet për Ndryshim edhe më herët kanë rritur bashkëpunimin midis organizatave anëtare, duke u mundësuar organizatave të rajoneve të ndryshme të Kosovës të



RrGK përmes Fondit të Grave të Kosovës ka ndarë gjithsejt 12 grante, për 14 organizata anëtare të saj në vlerë prej 47,992€.

bashkojnë forcat dhe të avokojnë së bashku. Bashkëpunime të tilla pritet të vazhdojnë edhe më tutje përmes këtyre granteve. Për shembull, Medica Kosova në partneritet me organizatën Djepi i Buzëqeshjes zhvilluan iniciativën “Përdorimi i qasjes së bazuar në komunitet dhe traumë për përmirësimin e qasjes së të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës gjatë procesit të njohjes së statusit të tyre”. Ndërsa Dera e Hapur në partneritet me organizatën *Ruka Ruci* (Dora Dorës) zhvilluan iniciativën “Çfarë sjell e nesërmja me mua!”. Përveç këtyre dy iniciativave në partneritet, iniciativat tjera të përkrahura nga RrGK të cilat do të vazhdojnë të zbatohen edhe gjatë vitit 2019, janë:

- Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës (OPDMK) me iniciativën “Shëndeti për të gjithë”;
- Shoqata e Grave “Aureola” me iniciativën “Avancimi i ligjit të trashëgimisë”;
- Shoqata e Mamive të Kosovës (ShMAKS) me iniciativën “Fuqizimi i rolit të shërbimit profesional të mamive”;
- Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar të Mitrovicës – Handikos Mitrovica me iniciativën “Depresioni tek nënat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe tek personat me aftësi të kufizuara”;
- Psikoterapeutët në Veprim me iniciativën “Avancimi i kujdesit paliativ në Kosovë dhe sensibilizimi i komunitetit për personat me nevoja të veçanta”;
- Luna me iniciativën “Promovimi dhe përkrahja e të drejtave të grave – kundër dhunës në baza gjinore”;



- Gruaja Bashkëkohore me iniciativën “Stigma e shoqërisë mbi seksualitetin”;
- Aleanca e Grave për Integrim me iniciativën “Vetëdijesimi i grave Rome, Ashkalike dhe Egjiptase në komunën e Ferizajit dhe Lipjanit për shëndetin e tyre”;
- Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës (QMGF) “Raba Voca” me iniciativën “Pushimi prindëror si model i ardhshëm në Kosovë”;
- Shoqata e Grave Femere "Krusha e Vogël" me iniciativën “Mbështetja e grave në menopauzë”;

Shtojca I. përmban një listë të të gjitha granteve të ndara nga FGK-ja në vitin 2018 dhe të rezultateve të pritura të tyre.

Nga vjeshta e vitit 2012 deri me 31 dhjetor 2017, si rezultat i iniciativave të ndryshme të anëtareve, kanë përfituar 19,564 persona.

Në vitin 2018, anëtarët e stafit të RrGK-së kanë ofruar 253 seanca mentorimi përmes e-mailit, telefonit dhe takimeve individuale për përfitueset e granteve të FGK-së. Komisioni për Shqyrtimin e Granteve, i përbërë prej 5 anëtarëve, po ashtu ka kontribuar në avancimin e kapaciteteve të anëtareve, duke shqyrtuar secilin aplikacion dhe duke dhënë këshilla praktike. Kjo ka ndihmuar anëtarët e RrGK-së që të dorëzojnë aplikacione më të mira te FGK dhe tek donatorë të tjerë.

Kapacitetet e stafit të RrGK janë rritur

Gjatë vitit 2018, RrGK ka vazhduar të ofrojë mundësi për anëtarët e stafit të saj, që të rrisin kapacitetet e tyre, përfshirë edhe ato që ndërlidhen me: avokimin tek Bashkimi Evropian; integrimin e perspektivës gjinore në dokumentet e Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësimit (IPA); analizën gjinore; Menaxhimin e Ndikimit Mjedisor, Gjinator dhe Social; feminizmin; administrimin e organizatave ndërkombëtare; strategjitë avokuese; aftësitë intervistuese lidhur me metodologjinë e vlerësimit administrativ; shkrimin e koncept dokumenteve; hartimin e strategjive avokuese; shkrimin e raporteve; monitorimin dhe vlerësimin; metodat e hulumtimit; përzgjedhjen e mostrës; dhe aftësitë e të folurit publik.



Është përmirësuar klima e financimit për organizatat për të drejtat e grave

Edhe pse disa iniciativa avokuese mund të ndërmerren në baza vullnetare, Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) të udhëhequra nga gratë ende kanë nevojë për burime të ndryshme në shumë aspekte të punës së

tyre të rëndësishme. Aktivizmi i qëndrueshëm për të drejtat e grave kërkon burime financiare dhe RrGK ka vazhduar përpjekjet e saj në drejtim të mobilizimit të burimeve të mjaftueshme nga akterët vendor dhe ndërkombëtar për mbështetjen e lëvizjes së grave në Kosovë dhe më gjerë. Për shembull, lidhur me raportin “Kujdes me PVGj-në”. Për shembull, lidhur me raportin “Kujdes me PVGj-në”, në aspektin e Planit të Veprimit Gjinnor II të BE-së, RrGK ka ndërmarrë disa takime avokuese gjithandej Ballkanit Perëndimor dhe në Bruksel, duke avokuar që BE-ja të përmirësojë përkrahjen e saj ndaj organizatave të ndryshme për të drejtat e grave.

Përmirësimi i vetëdijesimit institucional dhe publik për rëndësinë e zbritjeve tatimore për të mbështetur punën e rëndësishme të grupeve të të drejtave të grave

Për shkak të ndryshimeve të kornizës ligjore për shoqërinë civile, RrGK-ja nuk ishte në gjendje të punonte për këtë çështje në vitin 2018. Në vend të kësaj, RrGK u bashkua dhe mbështeti përpjekjet e tjera të avokimit të udhëhequra nga Fondacioni Kosovar i Shoqërisë Civile lidhur me ndryshimet ligjore.

Është zbatuar plani i RrGK-së për ngritjen e fondeve

Pavarësisht disa sfidave në fillim të vitit 2018, RrGK ka vazhduar ngritjen e fondeve dhe ka arritur që të sigurojë shumicën e burimeve financiare të nevojshme për të bërë të mundur progresin në zbatimin e Strategjisë së saj.



GRATË NË POLITIKË DHE VENDIMARRJE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe vendimmarrje në nivel komunal dhe qendror. RrGK ka shënuar përparim drejt përmbushjes së këtij qëllimi, siç tregon fakti që 14 politika janë ndryshuar në vitin 2018; në total që kur RrGK ka filluar të mbajë shënim këto informata. RrGK, anëtarët e saj dhe Lobi për Barazi Gjinore kanë avokuar me sukses për 151 ndryshime të politikave drejtë përmirësimit të jetës së grave dhe vajzave në nivel lokal dhe qendror. Për më tepër, avokimi i RrGK dhe ngritja e kapaciteteve, së bashku me përpjekjet e institucioneve, kanë kontribuar në rritjen e përdorimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor nga organizatat buxhetore, ku numri i komunave dhe ministrive që përdorin buxhetimin e përgjegjshëm gjinor është rritur nga dy në vitin 2014 në 63 (prej 94). Progresi drejt arritjes së këtij qëllimi afatgjatë më tutje ilustrohet nga arritjet që ndërlidhen me rezultatet e mëposhtme.

Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel komunal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore

Përmes Fondit të Grave të Kosovës, anëtarët e RrGK-së rritën numrin e qytetareve të ndryshme gra që morrën pjesë në politikë dhe procese vendimmarrëse me mbështetjen e anëtarëve nga Fondi nga 183 në vitin 2014 në 1,428 deri në vitin 2018. Për më tepër, në vitin 2018, anëtarët e Lobit organizuan 150



takime mes organizatave të të drejtave të grave dhe zyrtarëve për të avokuar për prioritetet e grave. Gjatë vitit 2018, RrGK arriti rezultatet e mëposhtme drejt këtij qëllimi.



Me 22 qershor 2018, u themelua Koalicioni për Barazi, i përbërë nga gratë në politikë nga niveli qendror dhe lokal dhe nga organizatat joqeveritare të udhëhequra nga gratë të cilat përkrahin dhe fuqizojnë njëra tjetrën në përmirësimin e pozitës së gruas në politikë, vendimmarrje dhe avancimin e barazisë gjinore në Kosovë.

Grupet Avokuese për Barazi Gjinore të themeluara dhe funksionale në 26 komuna dhe në nivel kombëtar

Në vitin 2014, anëtarët e Grupeve Avokuese për Barazi Gjinore kanë themeluar Lobin për Barazi Gjinore në Kosovë (këtej e tutje, Lobi). Anëtarët vendosën që edhe burrat dhe djemtë që përkrahin të drejtat e barabarta, mund t'i bashkangjiten këtij grupi. Aktualisht, grupet e Lobit janë funksionale në 26 komuna. Numri i grave të përfshira është rritur nga 400 në vitin 2015, në 1,262 në vitin 2018. Së bashku, ato ndërmorrën 78 iniciativa avokuese në nivel komunal dhe qendror në vitin 2018, duke kontribuar në ndryshimin e 14 politikave.

Me 12 prill 2018, gratë nga Suhareka organizuan mbledhjen e Lobit. Tema ishte “Solidariteti mes grave dhe rruga drejt pozitave vendimmarrëse”. Në këtë takim morën pjesë mbi 70 gra dhe vajza, duke përfshirë zyrtarët për barazi gjinore, asambleistët, përfaqësueset të organizatave anëtare të RrGK-së nga komuna të ndryshme, dhe anëtarët e stafit të RrGK-së.



Me 13 qershor 2018, Ambasadorja Nataliya Apostolova, Shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Përfaqësuese e Posaçme e BE-së, RrGK dhe Lobi bashkë-organizaun një takim në mes të grave në politikë, deputeteve, grave nga asamblatë komunale dhe zyrtareve për barazi gjinore. Takimi, në të cilin morën pjesë 73 gra, u thirr me qëllim që të planifikohen dhe të ideohen strategji për fuqizimin e pjesëmarrjes së grave politike në proceset vendimmarrëse në Kosovë.

Kjo çoi në takimin e dytë me 22 qershor 2018, ku 96 gra në politikë në nivelin qendror dhe lokal, organizata joqeveritare të udhëhequra nga gratë dhe gra aktiviste të cilat punojnë për të përmirësuar pozitën e gruas në politikë, themeluan **Koalicionin për Barazi**. Pjesëmarrëset u zotuan se do të punojnë drejt përmbushjes së misionit dhe vizionit të përbashkët për fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së grave në politikë dhe vendimarrje dhe arritjes së barazisë gjinore në Kosovë, pa marrë parasysh preferencat politike, gjininë, moshën, etnicitetin, aftësinë, religjionin,

Ambasadorja Nataliya Apostolova në fjalimin e saj theksoi rëndësinë e rolit të gruas, në veçanti gruas në politikë si dhe çfarë mund të bëjmë në avancimin e pozitës së gruas duke kontribuar kështu në arritjen e barazisë gjinore. Ajo u shpreh se “Një aspekt kyç është solidariteti. Ndonjëherë shoqëritë na mësojnë, si gra, të konkurojmë me njëra-tjetrën, për të nënvleftësuar njëra-tjetrën, për të ulur njëra-tjetrën poshtë. Ne duhet ta ndalojmë këtë rreth vicioz. Është kur mblidhemi dhe bëhemi bashkë, atëherë ne jemi më të fuqishme dhe bëjmë ndryshimet më të mëdha”.



pozitën gjeografike, nivelin e edukimit ose statusin shoqëror-ekonomik.

Me 7 nëntor, RrGK organizoi mbledhjen e tretë të Koalicionit për Barazi “Qeveria Feministe e Kosovës. Kur?”, ku morën pjesë 92 gra në politikë, organizata të udhëhequra nga gratë dhe gra aktiviste.

Të pranishmet diskutuan sfidat, strategjitë dhe solidaritetin që një ditë do t'i printe krijimit të një qeverie feministe në Kosovë.

“Asnjë grua nuk do të ishte përmendur në histori në qoftë se ato nuk do të ishin të bashkuara në kauzat e tyre”, u shpreh Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga në mbledhjen e themelimit të Koalicionit.

Ngritja e kapaciteteve të grave në politikë për të avokuar për prioritetet e mëtejshme të grave

Takimet e lartpërmendura po ashtu zhvilluan edhe më tej kapacitetet e grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave duke ofruar shembuj të praktikave më të mira dhe duke i përmirësuar aftësitë e tyre avokuese.

Drejt këtij rezultati, që nga viti 2015, Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së, Igballe Rogova, mbajti 1141 seanca mentorimi me grupet e Lobit nëpër Kosovë, përmes vizitave në komunat e tyre apo thirrjeve telefonike, përfshirë 480 seanca mentorimi vetëm në vitin 2018. Këto seanca shërbyen për të fuqizuar anëtarët e Lobit në avokimin e tyre për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. Është e rëndësishme të theksohet që RrGK-ja nuk i sheh apo trajton anëtarët e Lobit si anëtare të partive politike, por më tepër si udhëheqëse në komunat e tyre. Drejtorja ekzekutive e RrGK-së, gjithashtu ishte e



pranishme në ngjarjet e tyre, ka promovuar iniciativat e tyre, i ka mbështetur ato në avokim duke iu bashkuar në takimet me zyrtarët lokalë dhe i ka asistuar në tejkalimin e sfidave gjatë avokimeve të tyre drejt barazisë gjinore.

Rritja e vetëdijesimit për rëndësinë e përafrimit të Ligjit për Barazi Gjinore dhe ligjeve zgjedhore

Këtë vit, RrGK-ja ka vazhduar të avokojë për përafrimin e Ligjit për Barazi Gjinore me ligjet e tanishme zgjedhore përmes avokimit tek zyrtarët në Kosovë në bashkëpunim me përfaqësuesit e BE-së.

Gratë në politikë, organizatat e grave dhe gratë votuese komunikojnë dhe bashkëpunojnë më shumë rreth çështjeve që gratë i konsiderojnë prioritet

Përmes Koalicionit për Barazi, Lobit dhe RrGK-së, gratë nga sfera politike, shoqëria civile dhe gratë votuese kanë bashkëpunuar rreth çështjeve të rëndësishme për to gjatë vitit 2018. Në bashkëpunim të ngushtë me gratë votuese nga komunat e tyre, anëtarët e Lobit avokuan për çështjet që gratë i konsiderojnë prioritet, siç është qasja në shërbimet shëndetësore për nëna dhe fëmijë.

Avokimi i iniciuar për çështjet që gratë i konsiderojnë prioritet

Në vitin 2018, RrGK ka avokuar për disa ndryshime politikash. RrGK ka marrë pjesë në grupe punuese qeveritare dhe/ose ka ofruar komente në ligjet dhe politikat që do të ndikojnë në jetët e grave dhe vajzave. RrGK ka përkrahur përfshirjen e perspektivës gjinore, duke analizuar draftet e politikave publike (ligjeve, udhëzimeve administrative, strategjive, planeve të veprimit) nga një perspektivë gjinore dhe duke vlerësuar



ndikimin potencial që ato mund të kenë në burra, gra, vajza dhe djem. Politikat të cilat RrGK i ka ri-shikuar gjatë vitit 2018 nga një perspektivë gjinore dhe ka ofruar të dhëna përfshinin:

1. Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018 – 2022
2. Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
3. Raporti i Progresit të Kosovës për vitin 2019 (Raporti i Vendit)
4. Projekt-Kodi Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074
5. Pesë Dokumentet e Planifikimit Sektorial të IPA (Sundimi i ligjit, Bujqësia, Mjedisi, Energjia, Edukimi/Punësimi/Politikat Sociale)
6. 10 Dokumentet e Veprimit të IPA (Energjia, Kuvendi i Kosovës, Stabilizimi i Komuniteteve/Integrimi i Refugjatëve; Programet e BE; Drejtësia; Skema për të rinjtë, Arsimi, Mjedisi, Përkrahja për nisma të reja, dhe Vizibiliteti).

RrGK gjithashtu ka ndërmarrë disa takime avokuese tek Ministria e Integritimit Evropian, ministritë e linjës dhe zyrtarët e BE-së në Kosovë dhe Bruksel, duke kërkuar një përfshirje më të mirë të perspektivës gjinore në programet e tyre, më shumë konsultime me organizatat e të drejtave të grave në planifikimin e programeve dhe dialogje të politikave, si dhe konsultim më i mirë me Mekanizmat Kombëtar për Barazi Gjinore. Këtu përfshihen edhe disa takime avokuese në Kosovë, në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, në Suedi dhe Bruksel, për të avokuar për zbatimin e rekomandimeve të raportit “[Kujdes me PVGj-në](#)”, hulumtuar dhe përpiluar nga RrGK me mbështetjen e Fondacionit Kvinna till Kvinna.



PËRMIRËSIMI I QASJES SË GRAVE NË KUJDESHIN SHËNDETËSOR CILËSOR

Objektivi afatgjatë i këtij programi është që gratë të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor me kosto të përballueshme. Edhe pse RrGK ka pasur burime shumë të kufizuara për të bërë progres drejt arritjes së këtij qëllimi, RrGK ka bërë pak përparim, sikurse e ilustronë rezultatet e mëposhtme.

Zyrtarët publik dhe institucionet shëndetësore të jenë më përgjegjëse në adresimin e shkeljes së të drejtave të grave për kujdes shëndetësor

Pas publikimit të raportit hulumtues të RrGK “[Qasja në Kujdesin Shëndetësor në Kosovë](#)” në vitin 2017, së bashku me anëtarët e saj, RrGK krijoi Grupin Avokues për Shëndetësi (GASH). Në kuadër të GASH janë mbajtur disa takime me anëtarët e grupit, ku janë identifikuar fushat respektive në të cilat do të avokohet. Pjesë e këtij grupi janë: RrGK, Shoqata e Mamive të Kosovës, Shoqata Iniciativa e Grave dhe Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë. Gjatë vitit 2018, GASH ka mbajtur takime dhe ka avokuar për funksionalizimin e materniteteve në Kosovë. Në shkurt të këtij viti, RrGK dhe Shoqata e Mamive të Kosovës organizuan një tryezë të rumbullakët lidhur me mbylljen e materniteteve në Kosovë, shkaktarët si dhe mundësitë e rihapjes së tyre.

RrGK, gjithashtu, ka vazhduar të marrë pjesë në Koalicionin K10 për Shëndet dhe të Drejta Riprodhuese. Koalicioni K10 u themelua në vitin 2015 dhe përbëhet nga RrGK; Aksioni për Nënë dhe



Fëmijë; Asociacioni për Edukim dhe Zhvillim të Shëndetësisë; Artpolis; Shëndet për të Gjithë; Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit – Jeta/Vita; Fondi Kosovar për Popullsi; Shoqata Kosovare për Promovimin, Avancimin dhe Mbrojtjen e Shëndetit të Adoleshentëve; Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmohatar; dhe Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë. Gjatë këtij viti, anëtarët bashkëpunuan për të draftuar një strategji avokuese dhe plan tëi veprimit për këtë Koalicion.

Më shumë gra dhe vajza të vetëdijesuara për të drejtat e tyre dhe për rëndësinë e qasjes në kujdes shëndetësor; më shumë gra të vetëdijesuara si të zbulojnë shenjat e kancerit

Drejt arritjes së këtij qëllimi, RrGK përmes FGK-së, ka dhënë grante për të përkrahur gjashtë iniciativa nga organizatat e veta anëtare. Iniciativat e tyre do të vazhdojnë gjatë vitit 2019.

Të ketë hulumtim për dokumentimin e shkëljes së të drejtave të grave në kujdes shëndetësor

RrGK ka realizuar raportin hulumtues “[Qasja në Kujdesin Shëndetësor në Kosovë](#)” në vitin 2017, dhe ka vazhduar avokimin tek institucionet relevante për zbatimin e rekomandimeve të tij.



Më shumë zyrtarë publik, gra, vajza dhe burra janë në dijeni për të drejtën e grave për kujdes shëndetësor dhe shkeljet e të drejtave të tyre

Koalicioni K10 ka mbajtur diskutime të hapura me qytetarë mbi tema të ndryshme në lidhje me të drejtat dhe shëndetin riprodhues, si dhe takime me Asambleistët e Komunës së Prishtinës lidhur me bashkëpunime të mundshme në nivel lokal në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues.

Më shumë gra kanë qasje në kujdes shëndetësor cilësor

Përmes avokimit të sukseshëm të GASH tek Ministria e Shëndetësisë, materniteti i Kaçanikut, i cili ka qenë jofunksional për një kohë të gjatë, u ri-hap. Ndërkohë GASH vazhdoi avokimin tek kjo Ministri: kundër mbylljes së materniteteve nëpër komuna të tjera dhe ndikimin negativ që kjo ka në qasjen e grave në kujdes shëndetësor; rëndësinë e mamisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në



Me 24 shtator K10 organizoi një diskutim të hapur me temën Pëlqimi (Dhënia e Pëlqimit)/Konsentit për kyçje në marrëdhënie seksuale. Në këtë takim morrën pjesë dhjetra të rinjë.

maternitete; nevojën për përcaktimin e përshkrimit të punës së mamisë; dhe afërsinë e komunitetit me ofruesit e shërbimeve shëndetësore përmes decentralizimit.

*“Si rezultat i avokimit që kemi bërë tek Ministria e Shëndetësisë është rifunksionalizuar materniteti i Kaçanikut dhe tani gratë dhe vajzat në këtë rajon kanë mundësi të kryejnë kontrolla gjinekologjike pa pasur nevojë të udhëtojnë në qytet tjera siç ka ndodhur deri tani,”
u shpreh Magbule Elezi nga Shoqata e Mamive të Kosovës.*

Gratë dhe vajzat më të vetëdijshme për të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor dhe për rëndësinë e qasjes në kujdesin shëndetësor

Me 20 tetor, Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit Jeta/Vita, për të 11-tën herë me radhë organizoi manifestimin kulturor-informativ, ku qytetarë të shumtë kanë marshuar së bashku me moton e organizatës: “Zbulimi i Hershëm = Mbijetesë” për të shprehur solidaritetin dhe rritur sensibilizimin për kancerin e gjirit në shoqërinë kosovare.





Me 20 tetor Jeta Vita organizoi marshin “Zbulimi i Hershëm – Mbijetesë” për të shprehur solidaritetin dhe për të rritur sensibilizimin për kancerin e gjirit në shoqërinë kosovare.

JETA PA DHUNË ME BAZË GJINORE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë dhe vajzat të jetojnë një jetë të lirë nga dhuna me bazë gjinore. RrGK ka bërë progres drejt përbushjes së këtij qëllimi, siç e ilustrojnë edhe të arriturat drejt rezultateve në vazhdim.

Përmirësohet zbatimi i kornizës ligjore të dhunës në familje, duke përfshirë përgjigjet institucionale në ndihmën ndaj personave që kanë pësuar dhunë

Në mars, RrGK publikoi raportin “[Nga Fjalët në Vepra?](#)”, i cili vlerëson shkallën e zbatueshmërisë së kornizës ligjore në adresim të dhunës me bazë gjinore, si dhe njohuritë e institucioneve relevante lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre drejt zbatimit të kornizës ligjore. Raporti sugjeron që ende mbeten disa mangësi në trajtimin e dhunës me bazë gjinore nga ana e institucioneve. Një tregues i progresit drejt arritjes së këtij objekti është fakti se Kodi Penal është ndryshuar për të përfshirë definicionet specifike për dhunën në familje dhe ngacmimin seksual bazuar në rekomandimet dhe avokimin e RrGK dhe aktorëve të tjerë (shih më poshtë).



Ekzistojnë raportet që e monitorojnë zbatimin e kornizës ligjore të dhunës në familje, si dhe është rritur ndërgjegjësimi rreth kornizës ligjore dhe shtrirjes së dhunës në familje

Pas intervistave me mbi 80 përfaqësues të institucioneve dhe monitorimit të 179 rasteve të drejuara tek institucionet për ta adresuar dhunën me baza gjinore, të realizuar në vitin 2017, RrGK në mars të këtij viti lansoi raportin “Nga Fjalët në Vepra”. Në këtë raport u përmbledhën gjetjet nga monitorimi i RrGK-së si dhe u dhanë rekomandime specifike për secilin institucion në adresim të dhunës me baza gjinore. Në publikim të raportit, të pranishëm ishin akterët kryesor, ku RrGK avokoi për realizimin e rekomandimeve të dala nga ky raport.



Nga lansimi i raportit “Nga Fjalët në Vepra?” nga e majta në të djathtë: Biljana Rexhic, Sevdije Morina, Naim Qelaj, Ariana Qosaj-Mustafa, Igballe Rogova, Arsim Aziri, Adile Basha

Poashtu gjatë këtij viti, RrGK ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Këshillin Gjyqësor të Kosovës me qëllim të monitorimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore. Nga tetori i vitit 2018, RrGK ka arritur të rishikoj dokumentet e 161 rasteve nga arkivat e gjykatës themelore në Prishtinë, departamenti i krimeve të rënda. Gjatë vitit të ardhshëm RrGK do të vazhdojë monitorimin e rasteve të tjera, si dhe do të publikojë gjetjet nga procesi i monitorimit.

Institucionet dhe akterët e tjerë janë të vetëdijshëm për shkallën në të cilën është zbatuar korniza ligjore për dhunën në familje

Pas lansimit të raportit “Nga Fjalët në Vepra?”, RrGK ka mbajtur takime me shtatë përfaqësues të institucioneve për të avokuar në lidhje me zbatimin e kornizës ligjore për dhunën në familje. Janë mbajtur takime me Kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Udhëheqësen e Njësisë Kundër Dhunës në Familje në Policinë e Kosovës, përfaqësueset e strehimoreve, Odën e Avokatëve, dhe me akterë të tjerë relevant. Këto takime kanë pasur për qëllim të mbështesin institucionet në përmirësimin e punës së tyre në zbatimin e kornizës ligjore për dhunën në familje.



Ariana Qosaj Mustafa, Kryetare e Bordit të RrGK, iu drejtohet qytetarëve pjesëmarrës në protestën e mbajtur me 10 gusht në Gjakovë.

Gjatë muajit korrik, RrGK mori pjesë në takimin e organizuar nga UN Women dhe European Women's Lobby, ku u takuan aktivistet nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia me qëllim të draftimit të pikave avokuese, të cilat do të ngriteshin në Forumin Rajonal “Promovimi dhe Zbatimi i Konventës së Stambollit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”.

RrGK ka vazhduar të informojë përfaqësuesit e BE-së në Kosovë dhe Bruksel lidhur me mangësitë institucionale në zbatimin e kornizës ligjore të dhunës në familje dhe për të siguruar mbështetje në inkurajimin e institucioneve për të ndërmarrë reforma.

Anëtarët e RrGK janë angazhuar për zbatimin e kornizës ligjore për dhunën në familje

RrGK vazhdimisht ka bashkëpunuar me disa nga anëtarët e saja, përveç akterëve tjerë, në avokimin për zbatimin e kornizës ligjore. Janë



Fëmijët e së ndjerës Valbona Marku Nrecaj dhe familjarët tjerë të saj morrën pjesë në protestën e mbajtur me 10 gusht, pas vrasjes së saj dhe të bijës.

ndërmarrë disa iniciativa në bashkëpunim me strehimoret, si dhe janë ofruar shumë trajnime për ngritjen e kapaciteteve me qëllim të zbatimit me përpikshëmi të kornizës ligjore në luftimin e dhunës në familje.

RrGK ka vazhduar përdorimin e procedurave gjyqësore strategjike dhe monitorimin si një mënyrë e avokimit për përmirësimin e zbatimit të kornizës ligjore. Gjatë këtij viti RrGK ka ndihmuar familjen e të ndjerës Antigona Morina, e cila e gjeti vdekjen nga pakujdesia e bashkëshortit të saj. Pas ndihmës ligjore të ofruar nga RrGK, Hilmi Zena, bashkëshorti i të ndjerës, u dënua me dy vite burgim.

Me përkrahjen e RrGK, anëtarët kanë organizuar protestën #BollMo, në shtatë komuna të ndryshme të Kosovës, me qëllim të ngritjes së presionit publik për trajtim adekuat të institucioneve për rastet e dhunës në familje. Për më tepër, disa nga anëtarët e RrGK janë përfshirë në avokim për zbatimin e kornizës ligjore nëpër komunat e tyre, veçanërisht gjatë 16 Ditëve kundër Dhunës ndaj Grave.

Edhe këtë vit, RrGK ka vazhduar të jetë pjesë e Grupit për Siguri Gjinore, grup i cili është i përbërë nga palët e shumta të interesit me të cilat



*Me 10 gusht në Gjakovë u protestua për ti thënë
mjaft vrasjes së vajzave dhe grave!*

RrGK ka bashkëpunuar në avokim për të përmirësuar zbatimin e kornizës përkatëse ligjore. Kjo përfshinë avokimin për zbatimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020. Poashtu gjatë këtij viti, RrGK mori pjesë në disa grupe punuese të organizuara nga Kuvendi i Kosovës, në lidhje me finalizimin e definicionit të dhunës në familje në Projekt-Kodin Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074.

Performanca dhe cilësia e shërbimeve të strehimoreve është ngritur, veçanërisht në drejtim të rehabilitimit dhe ri-integrimit

RrGK ka vazhduar të avokojë për financim të qëndrueshëm për strehimoret në nivelin qendror dhe lokal, si dhe për përmirësim të monitorimit të cilësisë së shërbimeve. Poashtu, RrGK ka mentoruar dy udhëheqëset e posazgjedhura të strehimoreve në Prishtinë dhe Mitrovicë të cilat nga ky vit janë anëtarësuar në RrGK. Poashtu, RrGK ka mentoruar dhe mbështetur aktivistet e përfshira në procesin e hapjes së strehimores për gratë dhe vajzat serbe në komunën e Novobërdës, dhe ka vazhduar avokimin për strehimore në pjesën veriore të Kosovës.

Është përmirësuar ndërgjegjësimi dhe vëmendja në radhët e zyrtarëve dhe qytetarëve lidhur me trajtimin e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual

Në përgjithësi, së paku katër nga rekomandimet e hulumtimit të RrGK janë zbatuar gjatë vitit 2018. RrGK ka pasur më shumë se 92 paraqitje mediatike, për të ngritur vetëdijen ndër qytetarë lidhur me dhunën



në familje. dhe të ngrisë vetëdijen ndër qytetarët për këtë temë. RrGK ka arritur progres lidhur me rezultatet në vazhdim.

Më shumë qytetarë të informuar në lidhje me kornizën ligjore dhe të drejtat e tyre, duke përfshirë burrat

RrGK ka organizuar dhe bashkë-organizuar protesta dhe reagime të ndryshme, duke u bërë thirrje institucioneve vendore që të adresojnë dhunën me baza gjinore në përputhje me ligjet vendore. Protestat e organizuara janë: “Një Milion në Këmbë”; “MARShojmë S’Festojmë”; “#drejtësipërAntigonën; #drejtësipërDonjetën; si dhe protesta #BollMo e cila u mbajt në shtatë komuna të ndryshme. Në përgjithësi, përafërsisht 500 gra dhe burra janë përfshirë në fushatat vetëdijesuese gjatë vitit 2018. Tutje, përmes FGK-së, janë

Futen si vepër penale dhuna në familje dhe ngacmimi seksual pas avokimit të RrGK për ndryshim/plotësimin e Kodit Penal

Pas një avokimi të sukseshëm për futjen e dhunës në familje dhe ngacmimit seksual në Kodin Penal të plotësuar, këtë vit RrGK ka marrë pjesë në disa takime të grupit punues për ndryshim/plotësimin e Kodit Penal. Në këto takime, RrGK ka kontribuar përmes ekspertizës së saj, që këto dy vepra të definojnë në Kodin e Ri Penal, në pajtim me Konvëntën e Stambollit. Në nëntor u votuan ndryshimet e Kodit Penal, dhe dhuna në familje dhe ngacmimi seksual nga tash do të jenë vepra penale të dënuara konform dënimeve të parapara në Kodin Penal.



përkrahur edhe tri organizata anëtare të RrGK-së, iniciativat e të cilave do të kontribuojnë në vetëdijesimin e qytetarëve lidhur me kornizën ligjore dhe të drejtat e tyre, të cilat do të vazhdojnë të zbatohen gjatë vitit 2019.

Hartohen politikat dhe përmirësohen procedurat për trajtimin e ngacmimit seksual

Pas avokimit të RrGK-së për futjen e ngacmimit seksual si vepër penale në Projekt-Kodin Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074, propozimi i dhënë është aprovuar nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Kuvendi i Kosovës. Në vitin 2019 Kodi Penal i plotësuar dhe i ndryshuar do të hyjë në fuqi.

Poashtu, në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës (UP) “Hasan Prishtina”, RrGK, Artpolis dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), ishin pjesë e grupit punues të hartimit të rregullores dhe planit të veprimit të UP me qëllim të raportimit dhe parandalimit të ngacmimit seksual në UP. Nga viti i ardhshëm, UP do të ketë mekanizmat funksional në vend për adresimin e ngacmimit seksual.



Studentët mësojnë për ngacmimin seksual dhe kornizën ligjore për adresim të ngacmimeve seksuale. Fotografia: Artpolis

Koordinimi i themeluar mes OSHC-ve të udhëhequra nga gratë, institucioneve publike, si dhe vendeve të tjera të punës në drejtim të instalimit të mekanizmave të përmirësuar për raportimin dhe hetimin e rasteve të ngacmimit seksual

Nën organizimin e Artpolis është mbajtur punëtorja “Adresimi i Ngacmimit Seksual në Universitete” qëllimi i të cilës ka qenë të ngritet vetëdija e studentëve dhe mësimeve të UP-së mbi format e ngacmimit seksual dhe kornizën ligjore për adresim të ngacmimeve seksuale.

Poashtu, RrGK ka mbështetur protesat e studentëve të cilët kanë kërkuar shkarkimin e prorektoreve e cila kishe përdorur gjuhë seksiste gjatë një komunikimi në media, në lidhje me ngacmimet seksuale në universitet.

Përmirësohet mbështetja institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës

Në bashkëpunim të ngushtë me organizatat anëtare të RrGK të specializuara në ofrimin e ndihmës për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës, RrGK ka vazhduar të monitorojë zbatimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, i cili parasheh benefitet për të mbijetuarat e dhunës seksuale. RrGK ka përkrahur iniciativat që kanë synuar të informojnë të mbijetuarat e dhunës për këto benefite për të cilat ato kanë qasje, ka avokuar tek institucionet që të kenë qasje më të ndjeshme dhe ka përcjellur nëse gratë në realitet kanë pasur kushtet e duhura të aplikojnë për këto benefite në pajtueshmëri me procedurat e aplikimit.



Është përmirësuar përfshirja e RrGK dhe e anëtareve të saj në proceset për sigurimin e mbështetjes institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës

Organizatat anëtare të RrGK, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRMT), Medica Kosova, Medica Gjakova dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave kanë ofruar ndihmë për gratë në kërkim të të drejtave të tyre për benefitet që ofrohen nga shteti, siç edhe parashihen në ligjin e lartëpërmendur.



MBËSHTETJA PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë dhe burrat të kenë mundësi të barabarta ekonomike në shtëpi dhe në sferën publike. Në përgjithësi, një tregues i progresit në nivelin e ndikimit është fakti se duke ndjekur përpjekjet e RrGK dhe disa aktorëve të tjerë, përqindja e grave që zotërojnë pronën në Kosovë është rritur nga 7.9% në 2014 në 17% në vitin 2017. Progres i mëtijshëm është bërë drejt këtij qëllimi, siç tregohet nga progresi në rezultatet e mëposhtme.

Më shumë gra sigurojnë punësim

RrGK ka bërë përparim drejt këtij objekti afatgjatë që gratë të kenë qasje të barabartë në mundësi punësimi në Kosovë duke përkrahur përmirësimin e një mjedisi më të përshtatshëm që gratë të punojnë. Këtë vit, RrGK ka vazhduar të jetë pjesë e grupit punues për amendamentimin e Ligjit të Punës të Kosovës ku posaqërisht ka avokuar për ndryshim të neneve



Gjatë muajit maj, Demokracia për Zhvillim (D4D), organizoi një takim dy ditor për të prezantuar komentet e përbashkëta në draftin e parë të Ligjit të ri të punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

që kanë të bëjnë me pushimin e lehonisë, gjidhënjën dhe krijimin e një dispozite e cila e përcakton një pushim të përbashkët prindëror.

Prej hulumtimeve të realizuara nga RrGK dhe akterë të tjerë, është dokumentuar që diskriminimi gjinor në tregun e punës ka ndikim negativ në punësimin e grave në Kosovë. Për këtë arsye, në fillim të vitit 2018, RrGK ka nisur një bashkëpunim rajonal për të luftuar këtë dikuri. RrGK së bashku me koalicionin rajonal për adresim të diskriminimit, ku përfshihen organizata partenere nga Shqipëria, Maqedonia Veriore, Mali i Zi, Serbia dhe Bosna dhe Hercegovina do të vazhdojnë bashkëpunimin drejt avancimit të të drejtave të grave në punë edhe për tri vitet e ardhshme, financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga Bashkëpunimi Suedez për Zhvillim.

Institucionet dhe akterët kryesor më të vetëdijshëm për shkallën e diskriminimit me bazë gjinore në vendin e punës në Kosovë dhe mënyrat për t'i adresuar ato dhe përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe të sektorit privat për punësimin e grave

Si pjesë të aktiviteteve avokuese për amendamentimin e Ligjit të Punës të Kosovës (shih më lartë), RrGK ka arritur të rrisë vetëdijen e përfaqësuesëve të institucioneve dhe të sektoreve të ndryshme private në lidhje me diskriminimin gjinor në vendin e punës dhe punësimin e grave.



Gjithashtu, në kuadër të koalicionit rajonal për adresim të diskriminimit me bazë gjinore, në vitin 2018, RrGK ka realizuar hulumtimin ku, ndër të tjera, maten qëndrimet dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe akterëve kryesor, në veçanti përfaqësuesit e institucioneve publike, të cilët kanë përgjegjësi ligjore të adresojnë diskriminimin me bazë gjinore. Të dhënat e dalura nga këto intervista janë analizuar dhe janë futur në draft raportin, së bashku me një analizë ligjore dhe politike, që do të publikohen në fillim të vitit 2019. Hulumtimi do të ofrojë të dhëna bazike si dhe do të informojë aktivitetet e ardhshme avokuese dhe vetëdijesuese lidhur me adresimin e diskriminimit me bazë gjinore në Kosovë dhe në rajon.



Më shumë mundësi të përballueshme në dispozicion për përkuqdesje të fëmijëve

RrGK ka vazhduar të avokojë tek qeveria për hapjen e më shumë objekteve për kujdesin e fëmijëve apo për parashkollor që janë të përballueshme dhe të lehta për qasje. RrGK ka inkurajuar BE-në të ngrisë këtë çështje në Raportin e Kosovës, si dhe të ofrojnë fonde për hapjen e më shumë objekteve për parashkollor në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim. RrGK dhe anëtarët e Lobit po ashtu kanë vazhduar të avokojnë nëpër komunat e tyre për më shumë objekte për kujdesin e fëmijëve.

Më shumë gra kanë qasje në trashëgimi dhe pronësi

Mundësitë e barabarta në trashëgimi dhe pronë janë vendimtare për fuqizimin ekonomik të grave. Ndonëse RrGK ka pasur angazhim të limituar lidhur me këtë çështje gjatë vitit 2018, megjithatë ka avokuar për zgjatjen e Udhëzimit Administrativ për Regjistrimin e Pronës së Përbashkët, si dhe për përfshirjen e masave afirmative që do t'iu mundësonte grave vetëushqyese të regjistrojnë pronën në emrin e tyre.

Përmirësohet shkalla në të cilën politikat dhe programet e BE-së përfshijnë perspektivën gjinore dhe është përmirësuar mbikëqyrja nga një perspektivë gjinore në lidhje me politikat dhe programet e BE-së në Kosovë

RrGK ka publikuar raportin “[Kujdes me PVGj-në](#)” që vlerëson zbatimin e Planit të Veprimit Gjinor 2016 - 2020 (GAP II) të BE-së në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Ai u prezantua në Bruskel në praninë e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komisioni Evropian, nga Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësi të Mirë dhe Negociata për Zgjerim, nga Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim, nga Palët

“Ky raport [Kujdes me PVGj-në] është si lista e gjërave që duhet të bëni për të pastruar shtëpinë. Mund të mos ju pëlqejë, por është e dobishme sepse ju ndihmon për të pastruar shtëpinë”, u shpreh Charlotte Isaksson, Këshilltare e Lartë për Çështje Gjinore në Shërbimin e Veprimit të Jashtëm Evropian.



Punuese në Rajonin e Ballkanit Perëndimor (COWEB), si dhe nga Delegacionet/Zyret e BE-së në rajon dhe në Forumin Ndërkombëtar për Çështje Gjinore në Suedi. Përmes ofrimit të rekomandimeve të qarta për secilën nga palët e interesit drejt përmirësimit të zbatimit të PVGj II, raporti kishte ndikim të dukshëm në inkurajimin e delegacioneve/zyreve të BE-së, shteteve anëtare dhe Komisionit Evropian të ndërmarrin hapa drejt zbatimit të PVGj II.

RrGK gjithashtu ka realizuar një komentari të shkurtër mbi Raportin e Kosovës për vitin 2018, përfshirë këtu rekomandimet se si të përfshihet më mirë perspektiva gjinore. Ndërkohë, me mbështetjeje nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, RrGK ka dhënë kontribut nga një perspektivë gjinore në Raportin e Kosovës për vitin 2019. RrGK gjithashtu ka përgaditur disa letra dhe inpute të tjera drejt përfshirjes së perspektivës gjinore dhe përfshirjes së grave në proceset e anëtarësimit të Kosovës në BE, të cilat janë prezantuar në Bruksel dhe Kosovë në disa takime avokuese gjatë këtij viti. Në mesin e të tjerave, këtu përfshihet përgaditja e komenteve për [Rezolutën e Parlamentit Evropian për të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor](#), në bashkëpunim të ngushtë me partnerët në rajon. Shumica e komenteve të ofruara nga RrGK dhe partnerët tjerë të Kvinna till Kvinna u përfshinë në Rezolutën e aprovuar.

RrGK ka vazhduar të ofrojë mbështetje teknike për Zyren e BE-së, Ministrinë për Integritet Evropian (MIE), Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Zyrtarët për Barazi Gjinore në përfshirjen e perspektivës gjinore në programet e Instrumentit për Para-Anëtarësim (IPA) në Kosovë, përfshirë fazat e planifikimit dhe zbatimit. Për të përkrahur këtë proces, RrGK dhe BE publikuan *Analizën Gjinore të Kosovës* në tetor të vitit 2018, e cila sjellë së bashku të gjitha të dhënat e ndara sipas gjinisë që janë në dispozicion për secilin sektor. Siç edhe kërkohet nga PVGj II e BE-së, ky dokument është menduar t'i



shërbejë BE-së dhe akterëve të tjerë në planifikimin e veprimeve më efektive që përfshijnë një perspektivë gjinore. Raporti përmbanë rekomandime për objektivat dhe indikatorët që BE i konsideron prioritet, drejt avancimit të barazisë gjinore në fushat ku më së shumti ka nevojë. Gjetjet fillestare të *Analizës Gjinore të Kosovës* janë përdorur nga RrGK për të sugjeruar mënyra të mundshme përmes të cilave BE dhe Kosova do të mund të përfshinin një perspektivë gjinore në 10 Dokumentet e Veprimit të IPA.

Si pjesë e kontratës me BE, RrGK ka ofruar trajnime dhe mentorime për barazi gjinore për pothuajse të gjithë zyrtarët në Zyrën e BE-së në Kosovë, si dhe për zyrtarët e MIE dhe ministrive të linjës, drejt zhvillimit të kapaciteteve në integrimin gjinor në politikat dhe programet e BE. Këtë vit RrGK ka mbështetur edhe zhvillimin e draft Planit të Veprimit Gjinor të delegacionit të BE-së për vitin 2019-2020 në Kosovë dhe planit të zhvillimit të kapaciteteve për gjithë stafin lidhur me barazinë gjinore. RrGK gjithashtu ka përpiluar një raport të shpejtë mbi monitorimin e zbatimit të përkushtimeve gjinore të bëra në dokumentet e veprimit të IPA për vitet 2014-2016 deri më këtë datë.



Me 3 tetor, Zyra e BE në Kosovë dhe RrGK lansuan Analizën Gjinore të Kosovës.

VLERËSIMI I PUNËS SË RrGK

RrGK monitoron dhe vlerëson punën e vet në disa mënyra. RrGK ka zhvilluar një Databazë të Monitorimit dhe Vlerësimit me qëllim që të përcjellë progresin në indikatorët e rezultateve të menjëhershme (*output*), objektivat dhe nivelin e ndikimit me kalimin e kohës, bazuar në Strategjinë organizative të RrGK-së. Stafi e përditëson rregullisht databazën me të dhëna lidhur me indikatorët, gjë që mundëson raportimet semestrale tek anëtarët dhe këtë raportim vjetor. Për më tepër, në çdo takim të organizuar gjatë vitit 2018, anëtarët e RrGK kanë vlerësuar punën e RrGK përmes pyetësorëve (rezultatet e plota janë në dispozicion sipas kërkesës). Gjatë Kuvendit Vjetor të RrGK-së, anëtarët në mënyrë anonime e vlerësuan shumë pozitivisht punën e RrGK. Gjithashtu, punën e RrGK-së e kanë vlerësuar shumë pozitivisht edhe përkrahësit financiar. Më poshtë janë disa nga komentet e tyre:

“E vlefshme, në takime po realizohet bashkëpunimi dhe kordinimi i aktiviteteve” – anëtare

“Shumë e vlefshme, jam shumë e lumtur që jam anëtare e Rrjetit, këtu ndihem shumë e fuqishme” - anëtare

“Shumë të mirë, profesionale, aktive dhe motivuese” - donator

“Arritjet më të mëdha të Rrjetit përfshijnë edhe luftimin e dhunës ndaj grave, ku kanë arrit të ndryshojnë vendimin e gjykatës dhe rritjen e numrit të viteve të dënimit” - anëtare

“Arritjet më të mëdha të Rrjetit kanë qenë krijimi i Koalicionit për Barazi, publikimi i raporteve, ndarja e çmimit “Sevdije Ahmeti”, lobimi për strehimoret” - anëtare individuale

“Vetëm vazhdoni përpara, mos ndërroni, pa ju s’do kishim asgjë” – anëtare



RAPORTI FINANCIAR I RrGK PËR 2018

Raporti financiar në vijim përmban informata për periudhën 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018, lidhur me përkrahësit, projektet dhe fondet e pranuar dhe të shpenzuara të RrGK-së.


Donatorët	Titulli i iniciativës	Fondet e bartura nga viti 2017	Fondet e pranuar gjatë vitit 2018	Totali fondeve për 2018	Shpenzimet totale 01.01.2018 – 31.12.2018	Do të barten në vitin 2019
Agjencioni Austriak për Zhvillim 8299-01/2018 (01.01.2018-31.12.2020)	Avancimi i Iniciativave për të Drejtat e Grave		200,000	200,000	148,351	51,649
External Action of the European Union 2018/394402 (23.03.2018-28.02.2021)	Fuqizimi i rolit të Organizatave të Shoqërisë Civile në luftimin e Diskriminimit dhe avancimin		176,553	176,553	54,767	121,786

Donatorët	Titulli i iniciativës	Fondet e bartura nga viti 2017	Fondet e pranuar gjatë vitit 2018	Totali fondeve për 2018	Shpenzimet totale 01.01.2018 – 31.12.2018	Do të barten në vitin 2019
	e të drejtave të grave në punë					
External Action of the European Union 2018/404-465 (20.12.2018-20.12.2022)	Fuqizimi i pjesmarrjes së Grave në Politikë		135,537	135,537	203	135,334
Fondacioni Kvinna till Kvinna KO01SID16-31005 (01.01.2017-31.12.2018)	Barazia Gjinore në procesin e Anëtarësimit të Kosovës në BE		45,633	45,633	45,633	-
Fondacioni Kvinna till Kvinna BN55SID16 - (01.09.2017-30.06.2018)	Integrimi Gjinor në Programin IPA në	3,728	11,081	14,809	14,809	-

Donatorët	Titulli i iniciativës	Fondet e bartura nga viti 2017	Fondet e pranuar gjatë vitit 2018	Totali fondeve për 2018	Shpenzimet totale 01.01.2018 – 31.12.2018	Do të barten në vitin 2019
	Shtetet e Ballkanit Perëndimor					
Zyra e BE në Kosovë IPA(01.01.2017-30.09.2018)	Asistencë për integrimin gjinor në Programin IPA për Kosovë 2016	13,361	6,994	20,355	20,355	-
EUSR/PR/088/2018/NA-II (01.05.2018-30.06.2018)	Fuqizimi i Grave në Politikë dhe Vendimarrje		9,553	9,553	9,553	-
Altrusa	Fondi i Qëndrueshmërisë		1,012	1,012	966	46

Donatorët	Titulli i iniciativës	Fondet e bartura nga viti 2017	Fondet e pranuar gjatë vitit 2018	Totali fondeve për 2018	Shpenzimet totale 01.01.2018 – 31.12.2018	Do të barten në vitin 2019
Donacione individuale dhe të anëtarësisë së RrGK	Fondi i Qëndrueshmërisë	7,185	20,877	28,062	24,800	3,263
Totali		24,274	607,240	631,514	319,438	312,077

Shpërndarja e shpenzimeve për vitin 2018



Siç ilustron në grafikun, 23% e shpenzimeve të RrGK janë bërë për shpenzime operative dhe 27% për shpenzime të programit. Në fund të vitit 2018, 49% e fondeve janë bartur për tu shpenzuar gjatë vitit 2019.

Raporti i Auditimit të pavarur

Boditë të drejtorëve të Rrjeti i Grave të Kosoves –RrGK

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Rrjeti i Grave të Kosoves –RrGK (më tej: "Organizata") Prishtinë – Kosovë, të cilat përfshijnë Pasqyrën e pozitës financiare më 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parash për vitin që mbyllet me këtë datë si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmblledhje të politikave domethënëse kontabël. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Rrjetit të Grave të Kosoves –RrGK me datën 31 Dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parash për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike të cilat janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësinë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përfituara të auditimit janë të mjaftueshme dhe të përshkattshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrollin e tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e organizatës që të sigurojë vëmendësinë e saj, duke dhënë informacione, nëse janë të zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vëmendësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vëmendësisë përveç në rastin kur menaxhmenti synon ta lëkudojë ose të ndërprejë aktivitetet e organizatës, ose nëse nuk ka alternativë tjetër përveç se të veproje si më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqirjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësi të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfaqësojë opinionimin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të grupuara, mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimet që marrin përdoruesit haras në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtimshëmi me SNA-të, ne udhëtojmë gjykimin profesional dhe naqjen skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve, dhe përfshijmë evidencën të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përbërësive për të na ofruar bazë për opinionimin tonë. Rreziku i mospërfundimit të anomaliave materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfaqësojë matëveshje të fshesha, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrollëve të brendshme.
- Përfshijmë njohuri rreth kontrollit e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të përfaqësojmë procedurat e auditimit që janë të përbërësive për ato shtresa, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të organizatës.
- Vlerësojmë përshprehshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe të shpalljeve përkufizuese të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshprehshmërinë e përditimit të bazës kontabël të vëzhgimit, dhe bazuar në evidencën e përftuar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime domethënëse për shtetshmëri të organizatës për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri material, nga në kërkohet të shprehim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në lidhje me shpalljet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse një shpalljeje e tillë është e paqartëzueshme, duhet të modifikojmë opinionimin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të përftuar deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të bëjnë që organizata të ndërprejë veprimtarinë e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeveritjen, në mes të tjerave, edhe lidhur me fshatëveshmëri, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfaqësojë çfarido mangësie domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit.


Afrindza Çelickaj Gashi
Auditor i ligjor
Audit AB,
Prishtinë,
29.03.2019



RRETH NESH

Bordi Drejtues i RrGK

Ariana Qosaj Mustafa, Kryetare e Bordit, Drejtore e Programit, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Belgjzare Muharremi, Drejtore Ekzekutive, Dera e Hapur

